



Pranuar / Dorëzuar Prilijena / Prodato Received / Delivered	07-02-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBATORIA	589/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1216/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1216/2021 të datës 23.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga

kundër Vendimit me Nr.13-116/01-0107913/21 të datës 14.12.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 07.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.1216/2021 e datës 23.12.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.13-116/01-0107913/21 i datës 14.12.2021 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.
- III. Detyrohet Komisioni Disiplinor në Komunën e Podujevës, që brenda afatit prej 15 ditësh, të ndërmarr veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Podujevës, me datë 23.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6312/2021 të regjistruar me numër A.nr.1216/2021 në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.13-116/01-0107913/21 të datës 14.12.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.12.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Komuna e Podujevës. Këshilli më datë 19.01.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6312/2021 të regjistruar me numër A.nr.1216/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 23.12.2021; Kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore të datës 02.12.2021; Ftesën për seancë disiplinore të datës 08.12.2021; Vendimin Nr.13-116/01-0107913/21 të datës 14.12.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës; Procesverbalin e deklarimit në seancë dëgjimore të datës 10.12.2021; Publikimet e ankuesit në rrejtët sociale facebook të datës 16.10.2021, 18.11.2021, 25.10.2021, 10.10.2021, 25.11.2021, 20.11.2021, 27.11.2021, 18.11.2021, 23.11.2021; Postim nga Komuna e Podujevës i datës 29.09.2021, 06.10.2021, 07.10.2021, 11.10.2021, 28.10.2021, 03.12.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.12.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 19.01.2022; Akt Emërimit të datës 01.04.2015 në emër të ankuesit; Fletë dorëzimi të datës 08.12.2021; Ftesë për seancë dëgjimore për Kryetarin e Komunës së Podujevës e datës 08.12.2021; Procesverbal i seancës dëgjimore të Komisionit Disiplinor të datës 10.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, *sepse:*

Bazuar në shkesat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimit të datës 01.04.2015 është konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun* në Komunën e Podujevës. Kryetari i Komunës së Podujevës, me datë 02.12.2021 ka paraqitur kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin se i njëjti gjatë fushatës zgjedhore ka bërë propagandë dhe ka shprehur përkrahje ndaj subjektit dhe kandidatit të caktuar politik përmes rrjetit social facebook, gjatë orarit të punës.

Komisioni Disiplinor pranë Komunës së Podujevës, pas shqyrtimit të rastit, me datë 14.12.2021 ka nxjerr Vendimin me Nr.13-116/01-0107913/21 përmes të cilit e ka shpallur përgjegjës ankuesin dhe të njëjtit i ka shqiptuar masën disiplinore *"Ndalim i 20% të pagës për një periudhë prej 2 muaj"*.

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr.13-116/01-0107913/21 të datës 14.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komisioni Disiplinor ka nxjerr vendim të kundërligjshëm për faktin se të gjitha postimet kanë qenë në llogarinë e tij private, jashtë orarit zyrtar të punës dhe ditëve të vikendit, pa asnjë tendencë anshmërie dhe i njëjti pretendon se lejohet sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar Vendimin me Nr.13-116/01-0107913/21 të datës

14.12.2021 të Komisionit Disiplinor, dhe rrjedhimisht ka gjetur se Komisioni Disiplinor ka konstatuar se ankuesi në llogarinë e tij personale në facebook ka publikuar postime ku shihet qartazi se i njëjti ka bërë fushatë elektorale në përkrahje të subjektit politik dhe kandidatit për kryetar të Komunës, prandaj veprimet e ankuesit i cilëson si aktivitete politik në kuptim të dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë. Sipas Komisionit Disiplinor ankuesi këto postime i ka bërë në detyrat dhe funksionet e tij si Zyrtar i lartë për Komunikim me Publikun në Komunën e Podujevës, dhe me këto veprime ka bërë shkelje të nenit 22 paragrafi 1 dhe nenin 25 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 5 të Rregullores (QRK) Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil, dhe nenin 4 të Kodit të Etikes për Zyrtarët e Komunës së Podujevës. Rrjedhimisht Komisioni Disiplinor konstaton se ankuesi ka kryer shkelje të rëndë nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.8 të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me këtë çështje ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 2 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës, dhe nenit 22 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete politike vetëm jashtë orarit zyrtar të punës dhe jashtë ambienteve të institucioneve publike*, dhe në kuptim të kësaj dispozite ligjore Kolegji konstatoi se nëpunësit civil nuk i ndalohet pjesëmarrja në aktivitete politike jashtë orarit zyrtar të punës dhe jashtë ambienteve të institucionit ku punon.

Sipas nenit 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. *ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit*; 1.2. *kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit*; 1.3. *ndodhja e pasojës* 1.4. *ndodhja e dëmit*; dhe 1.5. *lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit*. Bazuar në këtë dispozitë ligjore, Kolegji vlerëson se për ekzistimin e përgjegjësia disiplinore duhet të përmbushen në mënyrë kumulative elementet e cekura si me lartë, respektivisht Komisioni Disiplinor duhet të konstatoi ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit, kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit, ndodhjen e pasojës, ndodhjen e dëmit, dhe të bëjë lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.

Andaj, meqenëse inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë nën supozimin se ankuesi ka bërë propagandë dhe ka shprehur përkrahje ndaj subjektit dhe kandidatit të caktuar politik përmes rrjetit social facebook, gjatë orarit të punës, Kolegji vlerëson se Komisionit Disiplinor nuk ka arritur të vërtetojë drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, me rastin e shpalljes përgjegjës të ankuesit sepse paraprakisht nuk ka konstatuar se me cilin veprim, duke përfshirë datën, orën dhe përmbajtjen e postimit, ankuesi ka bërë propagandë dhe ka shprehur përkrahje ndaj subjektit dhe kandidatit të caktuar politik, dhe si rrjedhojë ka bërë shkelje të rëndë disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.8 të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Rrjedhimisht, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka gjetur se Komisioni Disiplinor në vendimin e kontestuar vetëm ka bërë përshkrim të gjendjes faktike në mënyrë abstrakte duke e cekur se ankuesi ka publikuar postime në rrjetin social facebook, mirëpo nuk e ka konstatuar në mënyrë konkrete se me cilin veprim/postim, brenda orarit zyrtar të punës, ankuesi ka bërë shkelje disiplinore, dhe në këtë mënyrë nuk mund të konstatohet nëse janë konsumuar elementet e përgjegjësive disiplinore sipas nenit 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët

Publikë, sepse për shkeljen disiplinore që supozohet se është kryer nga ankuesi është me rendësi të dihet koha e kryerjes se veprimit dhe nga ky fakt vërtetohet edhe cilësia në të cilën ka vepruar ankuesi, dhe rrjedhimisht përgjegjësia lidhur me veprimin e kryer. Pra, Vendimi me Nr.13-116/01-0107913/21 i datës 14.12.2021 i Komisionit Disiplinor, nuk përmban shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi dhe faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit, veprim ky në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që të metat e tilla të aktit administrativ e bëjnë të paligjshëm Vendimin me Nr.13-116/01-0107913/21 të datës 14.12.2021 të Komisionit Disiplinor, në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si rezultat i kësaj nuk është i mundur trajtimi i ligjshmërisë së pretendimeve ankimore dhe vendosjes në mënyrë meritore lidhur me ankesën, andaj duke u bazuar në neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që lënda të kthehet në rivendosje të organi i njëjtë, gjegjësisht Komisioni Disiplinor në Komunën e Podujevës.

Komisioni Disiplinor në Komunën e Podujevës, në procedurë të rivendosjes, duhet t'i marr parasysh pikëpamjet juridike të këtij vendimi dhe t'i eliminoj të metat e konstatuara të aktit administrativ.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1216/2021

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

